



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014  
Nr.ref.:RK658/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI46/14**

Parashtrues

**Slobodan Vujičić**

**Kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Slobodan Vujičić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

## **Objekti i çështjes**

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta]

## **Baza juridike**

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

4. Më 12 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
5. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI46/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI46/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
6. Më 23 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe e informoi Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për kërkesën.
7. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

8. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *“[...] meqenëse malazetë nuk përfshihen në Kushtetutën e Kosovës dhe i përkasin të njëjtit grup gjuhësor dhe fetar me serbët, a mundet partia ‘Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazet’ të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të garojë për njërin nga 10 vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb?”*.
9. Parashtruesi i kërkesës nuk ofron asnjë deklaratë të mëtejshme apo argument në mbështetje të kërkesës.

## **Pranueshmëria e kërkesës**

10. Gjykata vëren se në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, ajo duhet të shqyrtojë kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
11. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesën përkatëse në Gjykatë.

12. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e mënyrës së aplikimit të dispozitës së Kushtetutës lidhur me 10 (dhjetë) vendet e garantuara për partitë, koalicionet, iniciativat e qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur duke shpallur vetveten si përfaqësues të komunitetit serb në Kosovë.
13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
14. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e zbatueshmërisë së një dispozite kushtetuese lidhur me zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Dispozita kushtetuese në fjalë është neni 57.1 i Kapitullit III të Kushtetutës, i cili parashikon: *“Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute”*.
15. Parashtruesi i kërkesës veçanërisht pretendon që malazezët i përkasin së njëjtës gjuhë dhe grup fetar si të serbëve në përputhje me nenin 57.1 të Kushtetutës dhe partia e tyre "Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazez" (Gradjanska Inicijativa Pripadnika Crnogorske Zajednice) duhet të jetë në gjendje të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të konkurrojë për një prej 10 (dhjetë) vendeve të garantuara, të rezervuara për komunitetin serb.
16. Siç kuptohet nga Gjykata, për sa i përket kërkesës për interpretim në lidhje me dispozitat e Kushtetutës, nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese që fuqizon parashtruesin e kërkesës që të referojë një kërkesë të tillë në Gjykatë. Vetëm palët e përmendura shprehimisht me Kushtetutë kanë një autorizim të tillë.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 93.10 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, *“Qeveria ka këto kompetenca: mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”*. Për më tepër, në rastin nr. KO98/11, Gjykata konstatoi se *“Sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës, Qeveria mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme”*. (shih rastin KO98/11, parashtrues i kërkesës: *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011; dhe shih rastin KO18/14, parashtruese e kërkesës: *Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 11 shkurtit 2014).
18. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 84.9 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, *“Presidenti i Republikës së Kosovës: mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”*.
19. Pasi që parashtruesi i kërkesës është një individ, ai/ajo ka të drejtë të parashtojë kërkesë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, individët ose personat juridikë mund të dorëzojnë kërkesë për t'i kontestuar vendimet e autoriteteve publike, që pretendohen të jenë marrë me shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, vetëm pasi

të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Mirëpo, këtu nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë.

20. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 të Kapitullit III të Kushtetutës.
21. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

